

Siguri

Të shtëna me armë në Prishtinë – Policia ia sekuestron 86 fishekë dhe “Beretta”-n 46-vjeçarit



Sinjali.com

15 Gusht 2026 11:48



Të shtëna me armë kanë alarmuar Policinë mbrëmjen e së premtes në Prishtinë, ku një 46-vjeçar është shoqëruar në stacion, ndërsa arma dhe një sasi municioni i janë sekuestruar, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është **Ahmet Qamil**.

Rasti ka ndodhur më 14 gusht, rreth orës 21:00, në rrugën “Nexhmi Llumnica”, ndërsa vetëm pak minuta më vonë Policia ka pranuar informatën për të shtëna me armë në këtë lokacion.

Njësia policore ka dalë në vendin e ngjarjes, ku fillimisht është gjetur një gëzhojë e kalibrit 9 mm, ndërsa aty është hasur edhe Qamil.

Gjatë intervenimit, tek 46-vjeçari është gjetur një pistoletë “Beretta 929”, e kalibrit 9×19 mm, për të cilën, sipas të dhënave të rastit, ai posedonte leje.

Megjithatë, arma është sekuestruar nga hetuesit dhe Forenzika së bashku me dy karikatorë, 86 fishekë të kalibrit 9×19 mm dhe gëzhojën e gjetur në vendngjarje.

Qamil është shoqëruar në Stacionin Policor Veriu, ku është intervistuar lidhur me rastin.

Pas konsultimit me Prokurorin kujdestar, rasti është iniciuar për “Përdorim të armës” dhe “Armëmbajtje pa leje”, ndërsa i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera